



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

KOLEGJI "BIZNESI"
28-1/21 Data 29.01/2021
PRISHTINË

Rregullore për Rishikimin dhe Vlerësimin e Personelit Akademik e Kolegjit BIZNESI" është hartuar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 "Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës", Statutin e Kolegjit neni 81, në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi dhe është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor i datës 29/01/2021, këtë:

RREGULLORE PËR RISHIKIMIN DHE VLERËSIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Neni 1

Kjo rregullore përfshin aktivitetin për rishikimin dhe vlerësimin e stafit akademik të Kolegji Biznesi

Neni 2

Rishikimi dhe vlerësimi i stafit do të përfshijë aktivitetin e perhershëm në Kolegjin Biznesi

Neni 3

Në rishikimin dhe vlerësimin e stafit akademik janë të përfshirë:

- KLMSH
- Zyra për Cilësi
- Bartësit e programeve
- Studentet
- Alumni
- Bashkëpunëtorët e jashtëm
- Dhe partnerët nga sektori ekonomik

Neni 4

Personeli akademik obligohet të bashkëpunoj më të gjitha mekanizmat vlerësues të brendshëm të Kolegjit Biznesi.

Neni 5

Rishikimi vlerësues për personalitetin akademik përfshin periudhën cdo tre vjet.

Neni 6

Përderisa vlerësimi i personelit akademike përfshin periudhën një vjecare për një vit akademik.

Neni 7

Kriteret për vlerësim

- Punimet shkencore të botuara me impakt faktor
- Pjesëmarrja në punën kërkimore shkencore
- Kontributin në komunitet
- Pjesëmarrja në konferenca , simpoziume shkencore
- Hartimi I projekteve për sektorin industrial
- Hartimi I projekteve dhe aplikimi I Kolegjit Biznesi në projektet e ERASMUSEN +

Neni 8

Vlerësimi bazohet në kriteret e motivimit individual të stafit dhe ekipor.

Neni 9

Vlerësimi është një proces gjithëpërfshirës që fillon nga përformanca e deri të kontributet në komunitet si hallkë e vlerësimit

Neni 10

Procedura e vlerësimit zhvillohet nga pyetësorët që organizohet nga Zyra për Cilësi , e cila më tutje shpërndan raportin në KLMSH, tek bartësit e programeve.

Neni 11

Zyra për Cilësi ofron në mënyrë individuale për stafin rekomandime për përmirësimin e cilësis dhe trajnimet e nevojshme për stafin.

Kryetari i KLMSH-Dekani

Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

